


# Frederick Turner, një avokat i përjetshëm në ndihmë të poezisë

GJEKË MARINAJ

Frederick (Frederik) Turner është i njohur si një nga poetët më cilësor në letërsinë e sotme botërore. Nëse lexuesi shqiptar do të hezitohet ta pranojë si të tillë, faji nuk mund të kërkohet në punën e tij si poet, por në punën time si përkthyes. Nuk mund të jetë ndryshe, sepse vargjet e tij janë thellësisht të fuqizuara, midis tjerash, nga intelektu i një profesori të shquar në fushën e letërsisë, nga emocionet e një njeriu të ndjeshëm ndaj njerëzimit, nga imagjinata dhe mendimet e një filozofi të sofistikuar, dhe nga një poet që ka kontroll të përhershëm mbi estetikën dhe kodet e tjera, të vjetra dhe të reja, të poezisë. Ndonëse të zgjedhura nga më se dymijë poezi, poezitë e përfshira *Në Shpellën e Platonit* nuk janë patjetër poezitë më të arrira të poetit anglo-amerikan, por më tepër shembuj nga shumëllojshmëria stilistike e poetit Frederick Turner. Gjithsesi, këtu kemi të bëjmë me një kullm të ri të natyrës poetike, me një penë dytëshe që në aspektin historik, shpërthimi poetik shënon një pikë kthesë për tek origjina e vjetër e poezisë, kurse në aspektin e risisë kemi të bëjmë me një poezi ku gjuha dhe imazhet, intimiteti dhe perspektiva, dashuria dhe shpresa riformohen për të gjetur një kimi të përbashkët me



lexuesin. Kjo është e rëndësishme veçanërisht kur dimë se rreth pesëdhjetë vjet më parë, kur Turner filloi të botojë për herë të parë, bota e poezisë ishte gjerësisht e dominuar nga tradicionalizmi poetik: vargje e lira imagjinatave dhe ekzistencialiste të shkruara zakonisht në vetën e parë. Turner, ndoshta më shumë se çdo poet tjetër, mbanë përgjegjësinë e rikthimit të formave të vjetra, si dhe për krijimin e disa prej formave të reja poetike, që sot gjejmë të aplikuara në poezinë bashkëkohore...

Që në librin e vet të parë, *Ndërmjet dy jetëve*, Turner tregoi një shikim të ri nga stili i atëhershëm i poezisë "rrëfyes" drejt një interesi të ri për poezinë narrative, ndonëse në atë kohë ai qe vlerësua pikërisht për vargjet e tij rrëfyes, të cilat qenë dëndësisht artistike, me imazhe surrealistike dhe adresime të drejtpërdrejta. Me fjalë të tjera, ai arriti të bëhet një mjeshtër i vërtet i njërës gjini vetëm sa për t'u kthyer tek tjetra. Por qe një lëvizje e paramenduar në të mirë të letërsisë. Në titullin e librit nuk bëhej fjalë vetëm për dy jetët e

poetit, njëra si anglez e tjetra si amerikan, apo për drejtimin e tij si profesor i ri apo për trokitjen tek ëndrrat rinore, por gjithashtu edhe për dy jetët e tij si poet rrëfyes bashkëkohorë dhe për poezinë e re publike, në të cilën arriti ta vejë edhe një herë në dispozicion për veten dhe poetët e tjerë që e dëshironin atë. Ekskursioni praktik i Turner-it drejt aplikimit me saktësi të formave metrike u pasurua ndjeshëm edhe nga teoria e fituar prej tij nga studimi me dedikim ndaj tyre. Frytet e studimeve u panë në esenë e famshme (një bashkëpunim me neurologun e njohur gjerman Ernst Pöppel) titulluar "Liria Natyrale: Metrika Poetike, Truri, dhe Koha," e cila shtroi një bazament të ri shkencor për formën poetike në poezinë amerikane. Bazamenti në fjalë shërbeu edhe si një shpjegim koherent se përse forma metrike ka qenë më shumë se një traditë kulturore lokale, duke dhënë për të kuptuar se ajo është një kapacitet universal human si melodia, piktura dhe gjuha.

Nga kjo pikë filluan të zhvillohen dy lëvizje të rëndësishme poetike, "Formalizmi i ri" dhe "Narrativi i ri" që të bashkuara sot njihen si "Poezia e zgjeruar" (Expansive Poetry). Në orbitën e këtyre lëvizjeve të orkestruara nga Turner lindën talente të reja që mbajnë një peshë të madhe në poezinë e sotme amerikane si Dana Gioia, James Merrill, John

Frederick Nims, Anthony Hecht, për të përmendur veç disa sish. Fakti që Turner ju përvish një pune serioze kërkimore me karakter shkencor për në thellësi të fundamentalizmit të artit të vet poetik, gjë që virtualisht nuk ishte dëgjuar që nga ditët e Getes, përbente një të veçantë të madhe në vetvete. Kjo do të ndihmonte ndjeshëm disa nga studiuesit e letërsisë botërore, të cilët i cituan emrin dhe arritjet shkencore të Turner-it në disa nga librat e referencave më të rëndësishme që njeh letërsia. Kjo u ushqye nga fakti se ashtu si dikur Valery, Coleridge, dhe Eliot, edhe ai konsiderohej ndër kritikët kryesor letrar. Puna e tij në veprën *Shekspiri dhe natyra e kohës*, e pat formuar me kohë reputacionin e tij, pastaj qenë një seri esesh dhe disa shkrime të veçanta të së njëjtës natyrë që e ngiitën edhe më lart. Por Turner po rigjallëronte traditën e poetit si mjeshtër i plotë i kontureve të një kulture të tërë—duke ndjekur shembullin e dikurshëm të Homerit, Virgjilit, Shekspirit dhe Miltonit, i vetëdijshëm se në shekullin e njëzetë një gjë e tillë nuk mund të arrihej pa një nivel të lartë njohurish shkencore, të cilat ja vuri vetes detyrë t'i fitonte. Këmbëngulja e tij për ta njohur sa më mirë shkencën si pjesë të pandarë të artit dhe për ta vënë atë me efektivitet në funksion të poezisë së tij, ka bërë që sot Turner të mbahet në një rrafsh të përafërt erudicioni me Erza Pound dhe Jorge Luis Borges.

## Turner: Poezia duhet patjetër të rikthejë në jetë kulturën humane


Në Librin e tij të titulluar *Kopështi*, që konsiderohet si libri më themelor i tij, Turner i thëllon kërkimet për një medium që do të restauronte fuqinë e vjetër intelektuale dhe shpirtërore të poezisë. Është një kombinim i përbashkët i poezisë dhe prozës që depërton drejt thellësisë së vizionit filozofik e shkencor të botës që jetojmë, duke e lartësuar vetëm atë vizion poetik që mbart në vetvete intelekt, pasion, ndjeshmëri dhe spontanitet. Në esencë, ai e natyralizon teologjinë dhe e mishëron atë në akord me ligjet shkencore, duke i përkthyer observimet shkencore në një fenomenologji poetike të pa transformuar në asnjë nga nivelet e saj. Megjithatë, ndoshta poezia epike dhe ajo narrative mbeten kontributi më i madh që Turner ka dhënë në të mirë të artit të poezisë bashkëkohore... Turner është i vetmi poet akademik, që di unë, që e ka kthyer veten në një avokat të përjetshëm në ndihmë të poezisë. Në librin *Klasizmi Natyral* ai jep bazat shkencore të teorisë së tij artistike

mbi krijimtarinë, antropologjinë etj, dhe mbi teorinë e tij mbi metrikën poetike. Libri tjetër i tij *Rilindja e Vlerave* sistemon konceptet filozofike që ai ndjek gjatë punës për aspektin estetik, ambientalizmin, edukimin dhe religionin në poezi. *Tempest*, *Flute* dhe *Oz*, titujt e të cilëve reflektojnë një projekt ku lidhë temat e Shekspirit, në *The Tempest* (*Stuhia*), të Mozartit në *The Magic Flute* (*Flauti Magjik*) dhe të librit klasik *The Wizard of Oz* (*Magjistari i Oz-it*), është një koleksion esesh që zgjatet si një segment akademik nga e kaluara e largët për tek e ardhmja. Aty përfshihen edhe tema të tjera të rëndësishme për njerëzimin si globalizmi, kolonizimi hapësinorë, inteligjenca artificiale, si dhe komunikimet më të ardhmen. Ndërsa në veprën *Kultura e Shpresës*, Turner shpjegon se si idetë e tij mund të ndërhyjnë dhe korrektojnë kulturën e luftës që po dërmon botën dhe sfidon artistët të shikojnë përtej perspektivave të vyshkura të

modernizmit dha pas-modernizmit, duke sugjeruar reagime pozitive në vend të reagimeve negative kundrejt feminizmit, pas-kolonializmit, dhe ambientalizmit. Ndërsa bazamentin e pasqyrës morale të kapitalizmit, Turner e deshifron në *Ekonomitë e Shekullit Njëzetënjë të Shekspirit*, një libër ky që ka pushtuar libraritë publike, shkollorë dhe ato personale të akademikëve të botës brenda dy muajve të parë të daljes në treg.

Duke përdorur bagazhin e jashtëzakonshëm akademik që zotëron, Turner merr përsipër përgjegjësinë jo vetëm për stilistikën letrare, por edhe për trupin e lëndës që ndihmon në zgjerimin e ideve për një funksionimin më me efikasitet të sferave që e ndihmojnë mbajtjen gjallë të seriozitetit me të cilin duhet të trajtohet letërsia në përgjithësi e poezia në veçanti. Ai nuk insiston vetëm në unitetin e kulturave letrare, por edhe në funksionimin e tyre si një pikë ku hipotezat imagjinatave për njeriun e të ardhmes janë të

konceptuara dhe provuara për koherence imagjinuese. Duke qartësuar spekulimet e pasura dhe idetë kritike përtej hapësirës artistike të poezisë së tij, ai bashkohet në traditën e poetëve të mëdhenj publik përfshi këtu Miltonin, Geten, dhe Danten. Një gjë e tillë mund të arrihej vetëm nga Frederick Turner, sepse filozofia e poezisë së tij mbështetet në të vërtetën e rëndësishme se poezia duhet patjetër të rikthejë në jetë kulturën humane. Turner jeton në poezinë e tij si shërbyes i të gjithave kulturave të botës. Ai është poetikisht i dashuruar pas botës, sepse e ka jetuar shpirtërisht dhe fizikisht atë. Vlen për t'u përmendura fakti se, ndonëse i lindur në Britaninë e Madhe, fëmijërinë e tij e kaloi duke fjetur nëpër çadra pyllishtave të Afrikës Qendrore, teksa prindërit e tij Viktor E. dhe Edith L. B. Turner, bënin kërkime në fushën e antropologjisë... Por çmimin më të madh për poezinë e poetit Frederick Turner nuk e ka fituar ai si autor, por e kemi fituar ne lexuesit, nëpërmes



poezisë së tij. Ai po bën punën e tij që shekulli që jetojmë të kthehet në një pasqyrë të pastër poetike, ku të shfaqen qartë imazhet e freskëta dhe tingujt e së kaluarës, ku realiteti virtual do të jetë gjithësia njerëzore. Një klishe bashkëkohore na jep të kuptojmë se vëmendja jonë duhet të përqendrohet tek e ardhmja ngaqë atje do të kalojmë të gjithë jetën letrare.

(Botuar me shkurtime)